

VENDIM
Nr. 241, datë 2.12.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING”
SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 82, datë 24.4.2025; nr. 256, datë 15.10.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 145/4 prot., datë 25.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 226, datë 9.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 6/23 prot., datë 10.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Shoqëria me shkresat nr. 1021/2 prot. dhe nr. 10.21/3 prot., datë 15.11.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacion dhe informacion mbi aplikimin.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar në zbatim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike, neni 9 pika 4.7, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “h”, plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike:

neni 9, pika 4.7:

- germa “e” (sistemin IT-së së krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët, për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Duke qenë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që t’i lihet kusht shoqërisë depozitimi në ERE i sistemit IT, me fillimin e operimit;

- germa “g” (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve).

- Shoqëria ka përcjellë në ERE kontratë qiraje (kontratë nënqiraje), objekti i saj është dhënia me nënqira, te shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., e një sipërfaqeje për zyra. Sipas dispozitave të kontratës, afati i saj ka filluar në datën 21.10.2021 dhe do të përfundojë në datën

20.9.2024, ndaj, duke qenë se kjo nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave që disponon, jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. *Shoqëria 'AlbEsp Trading & Consulting' sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave të rinovuar, brenda datës 1.11.2026.*

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti